

Bashkia Lezhë

Adresa : Sheshi Gjergj Kastrioti, Lezhë, 4501

<https://lezha.gov.al> Tel. 045629883

Të dashur qytetarë!

Pjesëmarrja juaj dhe aktivizimi në jetën social - ekonomike të qytetit tonë do të jetë gjithmonë rruga e zgjidhjes së problemeve të përbashkëta. Të bashkuar mund të arrijmë objektivat e vendosura bashkarisht, për ta bërë qytetin tonë, Lezhën, më atraktiv për vizitorët dhe më të jetueshëm për qytetarët

Pjerin Ndreu

Kryetar

Plani i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane

Këshilli Bashkia me VKB nr. 46, datë 17.03.2021 " Për miratimin e planit të menaxhimit të mbetjeve urbane për vitet 2021-2025", ka miratuar Planin i Menaxhimit të Mbetjeve. Zbatimi i këtij Plani ka sjellë përmirësimin ndjeshëm të shërbimit dhe një qytet më të pastër.

Puna ka filluar tashmë edhe për hartimin e planit të ri të menaxhimit të mbetjeve, që synon në kalimin në standarde më të larta të ofrimit të shërbimit

Identifikim dhe zgjidhje problematikash

Kontenierët e mbushur me mbeturina gjatë ditës janë burim ndotjesh për mjedisin. Hedhja e mbeturinave të orare të caktuara nga qytetarët dhe bizneset mund ta zgjidhë këtë shqetësim. Pilotimi në NJA Shëngjir sensibilizimi i komunitetit dhe hartimi i një plani masash konkret për zbatim do të na cojnë hapa pas hapi në zgjidhjen e problemit dhe krijimin e mundësisë të aplikimit në të gjithë territorin e bashkisë.

Tarifat dhe kostot

Aplikojmë tarifa të diferencuara dhe të përballeshme për familjarë dhe biznesin. Mbulojmë kostot e shërbimit me të ardhurat e realizuara



Menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane – si prioritet i Bashkisë Lezhë

Nisma të ndërmarra

- ✓ Procesi i pastrimit derë më derë në Njësinë Administrative Shëngjin
- ✓ Hedhja e mbetjeve me orarë të përcaktuar nga bizneset dhe familjarët.



Hedhja e mbeturinave në orare të caktuara ka sjellë efektin e duhur duke e shndëruar qytetin në një ambient pa mbetje gjatë ditës



Kënaqshmëria e komunitetit

Sipas anketimeve të kryera rezulton se shërbimi i pastrimit është përmiresuar ndjeshëm dhe është rritur kënaqshmëria e qytetareve. Kjo evidentohet qartë edhe me faktin e uljes ndjeshëm të numrit të ankesave të banorëve për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

Fushata sensibilizuese

Fushatat sensibilizuese me institucionet, me nxënësit e shkollave dhe grupe të ndryshme shoqërore, janë pjesë e rëndësishme e punës sonë. Ato realizohen me moton "të bëhemi bashkë për të mbajtur pastër ambientit".

Instrumenti i ofrimit të shërbimit

Ofrimi i shërbimit realizohet nëpërmjet një partneriteti të vecantë publik-privat. Një subjekt privat dhe punëtorët e bashkisë, koordinojnë së bashku veprimtarinë për një qytet të pastër dhe menaxhim të integruar të mbetjeve urbane. Zgjedhja e këtij partneriteti në ofrimin e shërbimit ka rezultuar si instrumenti më efektiv që garanton një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

Mbulimi i territorit

Bashkia mbulon 100% të territorit me shërbimin e trajtimit të mbetjeve urbane. Bashkia Lezhë për efekt të menaxhimit të mbetjeve ka bërë ndarje në 3 zona bazuar në numrin e popullsisë rezidente si dhe fluksin turistik të zonës ku shërbimi ofrohet: Zona 1 që mbulon Nj.A. Lezhë dhe Nj.A. Shengjin si zone me e populluar dhe me një fluks turizmi me të lartë, pastrohet 2 here ne ditë.

Ndarja e mbetjeve dhe riciklimi

Zvogëlimi i sasisë së mbetjeve të destinuara për groposje është objektivi i punës sonë. Mundësia e ndarjes së mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar në destinacion po e diskutojmë si pjesë të planit të ri të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Turizmi dhe mjedisi

Kujdes të shtuar i kemi kushtuar pastrimit të plazheve dhe boshimit të kontenierëve me frekuencë të shtuar gjatë mbipopullimit për shkak të numrit të lartë të turistëve, duke e konsideruar higjenën dhe mjedisin e pastër si kusht themelor për zhvillimin e një turizmi të qendrueshëm.



Objektiva për të ardhmen

- ✓ Të shtrijmë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në mënyrë të unifikuar që garanton optimizimin e kostove në 97% të territorit të bashkisë.
- ✓ Të sigurojmë grumbullimin në masën maksimale të sasisë se mbetjeve të gjeneruara dhe të garantojmë eliminimin e të gjitha depozitimeve të përkohëshme të pakontrolluara brenda territorit të bashkisë.
- ✓ Të sigurojmë në mënyrë graduale infrastrukturën dhe zbatimin e skemës optimale të nevojshme për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar për të përmbushur objektivat kombëtare të reduktimit dhe ripërdorimit të mbetjeve.
- ✓ Të sigurojmë skema efektive në bashkëpunim me organizatat lokale dhe kompanitë e pastrimit për reduktimin e mbetjeve të destinuara për destinacionin final si shkak i aktivitetit të riciklimit dhe kompostimit.
- ✓ Të realizojmë në mënyrë graduale dhe në përputhje me parimin "ndotësi pagan" mbulimin e kostos së shërbimit nga të ardhurat prej tarifës duke marrë në konsideratë mundësitë dhe vullnetin e banorëve, bizneseve dhe institucioneve për të paguar.